



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO  
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE/A

RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

Njësia Nr./Br./No 01 Kuvendi i  
Kuvendi i Komunës / Skupština Opštine/A  
Nr. i fakteve / Broj / No. činjenica  
347/22

Data/Datum/Date 29.06.2022



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.06.2022, miraton këtë:

### V E N D I M

#### Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510052-00369-0 në Zonën Kadastrale Mrasor

1. Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510052-00369-0 në Zonën Kadastrale Mrasor, në sipërfaqe prej 240m<sup>2</sup> (dyqind e dyzet metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10610m<sup>2</sup> (dhjetëmijë e gjashtëqind e dhjetë metra katror) në vendin e quajtur Ornica – Livada vila, me kulturë arë e klasës 7, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Sokol (Rexh) Rexhepi nga fshati Mrasor, Komuna e Rahovecit.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Meremetimi i shtabit të UÇK-së në zonën e Mrasorit".
3. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
4. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

Nr. 347/22  
Datë: 29.06.2022



Definim i Kafexhllar  
Kryetari i Kuvendit